



unicef 
for every child

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
ADMINISTRATORI

Nr. 3583/Prot.
5

Tiranë, më 19/01/2023

FTESË PËR APLIKIM

Nr. 2/2, Datë 19.01.2023

Për

“Ekspert i jashtëm për vlerësimin e kurrikulës”

Financuar në kuadër të Programit të UNICEF “2022-2026”

DREJTUAR: TË GJITHË TË INTERESUARËVE PËR TË MARRË PJESË

Publikuar në website-n e Universitetit të Tiranës

Referimi ynë: Urdhër nr.2, datë 19.01.2023

Subjekti: Thirrje për aplikim me objekt **“Ekspert i jashtëm për vlerësimin e kurrikulës”**

Të nderuar Zonja / Zotërinj,

Rektorati i Universitetit të Tiranës, në zbatim të projektit të financuar nga Programi UNICEF për Shqipërinë, miratuar nga Bordi i Ekzekutimit të UNICEF për periudhën 2022-2026, në Programme Cooperation Agreement, marrëveshjen midis UT dhe UNICEF, për projektin me titull **“Social Work Curriculum strengthened for a highly qualified social workforce able to Work, mobilize and change community behaviours”** me nr.ref: ALB/PCA202237, në Ligjin nr.44, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSh”, në Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 8/1/b, si dhe në vijim të kërkesës së Fakultetit të Shkencave Sociale, përcjellë Administratorit nga DKSHPMJ me nr.prot.3583/1, datë 10.01.2023 për thirrjen për aplikime në kuadër të projektit, si dhe në vijim të Urdhrit nr.2, datë 19.01.2023,

Ju fton të paraqisni ofertën tuaj me objekt **“Ekspert i jashtëm për vlerësimin e kurrikulës”** sipas Termave të referencës bashkëlidhur:

Buxheti/Budget:

Fondi limit i parashikuar është 600,000.00 (gjashtëqind mijë) lekë/ALL pa tvsh.

Nga kandidatët kërkohet që të bëjnë oferta financiare nën këtë buxhet maksimal.

Vendi dhe data e dorëzimit të ofertës/ Place and date of bid submission:

Aplikimet duhet të dorëzohen ekskluzivisht në autoritetin kontraktor në protokoll, në një zarf të mbyllur të vulosur dhe firmosur, në adresën:

Universiteti i Tiranës
Address: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, Shqipëri

Afati i fundit i dorëzimit të ofertave do të jetë data **31.01.2023, deri në ora 12:00 pm.**

Kriteret e përjashtimit/ Exclusion criteria:

Aplikuesit/edhe Ofertuesi i huaj, duhet të vërtetojnë se përmbushin situatat e renditura më poshtë duke plotësuar formularin e vetdeklarimit mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme ligjore bashkëlidhur kësaj ftesë (shtojca 2):

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e thirrjes. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse” në rastin kur është person fizik/shpk.
 - b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv) në rastin kur është person fizik/shpk,
 - c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale,
 - d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- *Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.*

Kriteret e përzgjedhjes/Selection criteria:

Operatorët ekonomik duhet të dorëzojnë në një zarf të mbyllur të firmosur (i perbere nga 2 zarfa të brendshme të mbyllur A dhe B), me protokoll pranë autoritetit kontraktor, jo me vonë se data dhe ora e caktuar, plotësimin e dokumentave si më poshtë (dhe sipas shtojcave bashkëlidhur):

Propozimi financiar (me shënimin - Zarfi A).

1. Formulari i ofertës ekonomike, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur (me shënimin Zarfi A).

Propozimi teknik (me shënimin - Zarfi B).

2. Formulari i vetdeklarimit, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur.
3. Letër interesi.
4. CV.
5. Propozim të shkurtër teknik mbi metodologjinë dhe procesin.

Dokumentat e mësipërme duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre e të përkthyer. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Kriteri i vlerësimit /Award criteria:

Kontrata do ti jepet Aplikantit që arrin rezultatin më të lartë të kombinuar të propozimit teknik dhe financiar. Çdo aplikant duhet të paraqesë një propozim teknik dhe një propozim ekonomik (në zarfa të veçanta).

Kriteret e vlerësimit dhe dhënies që do të përdoren për këtë ofertë janë: Vlerësimi i Analizës Kumulative (sistemi i pikëve me atribuum të peshës).

Komponenti teknik do të përbëjë 80 pikë të peshës totale për pikë maksimale të kombinuar prej 100 pikësh, ndërsa komponenti financiar do të jetë 20 pikë.

1. Vlerësimi i propozimit teknik do të vlerësohet sipas nënkritereve të mëposhtme:

Nënkriteret teknike	Pikët maksimale
(i) Përvoja akademike dhe kualifikimet (licensimet)	[30]
(ii) Metodologjia e propozuar	[20]
(iii) Eksperenca përkatëse	[30]

Totali i pikëve maksimale për propozimin teknik është 80.

Vetëm aplikimet që marrin të paktën nga anëtarët e KVO mesatarisht 65 pikë, që mbulojnë të gjitha rezultatet/hapat e specifikuar në propozimin teknik (në përputhje me ToR) do të vlerësohen më tej për kriterin financiar.

2. Shqyrtimi i propozimit financiar bazohet në parimin e bazuar në vlerën për paranë, duke siguruar pikët më të larta për ofertën më të ulët

- Vlerësimi i Propozimit Financiar kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe - Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu - Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç - Çmimi Ofertues i Radhës (*duke filluar nga çmimi më i ulët*)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

3. Vlerësimi përfundimtar:

- Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: X = (pikët e propozimit teknik x 0.8)

Pesha për Propozimin Ekonomik: Y = (pikët e propozimit ekonomik x 0.2)

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik.

- Formula e llogaritjes është si më poshtë:

$$\text{Oferta më e mirë} = X + Y$$

Aplikanti që ka marrë më shumë pikë gjatë mbledhjes së pikëve teknike dhe ekonomike do të ftohet për negociata dhe lidhjen e kontratës.

Kohëzgjatja e kontratës/ Duration of contract:

Afati i realizimit të shërbimit, do të jetë deri në 31 Korrik 2023 nga data e nënshkrimit të kontratës.

Nënkontraktimi / outsourcing:

Nënkontraktimi nuk është i lejuar.

Vlefshmëria e tenderit / Tender validity:

Tenderi është i vlefshëm për një periudhë prej 3 muajsh pas afatit të fundit për dorëzimin e ofertave. Në rrethana të jashtëzakonshme, autoriteti kontraktor mund, para skadimit të periudhës së vlefshmërisë, të kërkojë që tenderuesit të zgjasin vlefshmërinë e ofertave për një periudhë specifike.

Gjuha e tenderit / Tender language:

Oferta e tenderit dorëzohet në shqip. Dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Ofertat e tenderit të paraqitura në ndonjë gjuhë tjetër do të refuzohen automatikisht.

Draft Formulari i kontratës është bashkëlidhur.



Shtojca 1

[Shtojca për t'u plotësuar nga Aplikanti]

Datë 31.01.2023

FORMULARI I OFERTËS FINANCIARE

Emri i Aplikantit: _____

Për: **Universitetin e Tiranës**

Projekt i financuar në kuadër të Programit të **UNICEF “2022-2026”**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Ekspert i jashtëm për vlerësimin e kurrikulës”**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës është _____ (vlera në shifra dhe fjalë) **ALL pa TVSh;**
2. Çmimi total i ofertës është _____ (vlera në shifra dhe fjalë) **ALL me TVSh.** (nese aplikohet)

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit _____

Shtojca 2

(Shtojcë për tu paraqitur nga Aplikanti)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë, i nënshkruari _____ në cilësinë e Aplikantit, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigja
Emri i Aplikantit:	-----
Numri ID / NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Aplikanti nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Aplikanti nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Aplikanti deklaron se plotëson të gjitha termat e references, siç udhëzohet në ftesë, dhe këtë e provon përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe merr përsipër të realizon objektin në përputhje me to.</p>

B: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

Emri, Mbiemri _____

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _____

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

KONTRATË SHËRBIMI (DRAFT FORMULARI I KONTRATËS)

Lidhur midis palëve të mëposhtme:

Autoriteti Kontraktor: UNIVERSITETI I TIRANËS, përfaqësuar nga Administratori, Z. Skerdi DAFA, me adresë Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, me Nipt J61915033D, nga njëra anë,

dhe

Kontraktuesi: “.....”, përfaqësuar nga Z/Zj....., me adresë, me ID/NIPT, nga ana tjetër.

Neni 1: Subjekti i kontratës

Subjekti i kontratës është shërbimi me objekt “**Ekspert i jashtëm për vlerësimin e kurrikulës**”, në Tiranë, Albania.

Kontraktuesi do të ekzekutojë detyrat që i janë caktuar në përputhje me termat e referencës bashkangjitur kontratës (Aneksi II).

Neni 2: Vlera e kontratës

Kjo kontratë, e shprehur në ALL/lek, është një kontratë me çmim global.

Vlera totale e kontratës për zbatim është: (...) **ALL pa TVSh** dhe/ose (...) **ALL me TVSh**. Çmimi nuk mund të rishikohet.

Neni 3: Dokumentet kontraktuese

Dokumentet që bëjnë pjesë në këtë kontratë janë (sipas rendit të përparësisë):

- oferta financiare (Annex I);
- termat e referencës (Annex II)

Neni 4: Dispozita të përgjithshme

Kontraktuesi do të ekzekutojë kontratën me kujdesin e duhur, efikasitetin dhe përkushtimin në përputhje me praktikën më të mirë profesionale.

Detyrimet e përgjithshme të Ekspertit janë të përcaktuara në Termat e Referencës (Aneksi II), që i bashkëlidhet kësaj kontrate.

Neni 5: Shërbimi dhe pagesat

Kontraktuesi do të ofrojë pa rezerva shërbimin sipas ofertës financiare “Aneksi I”. Shërbimet do të zbatohen brenda periudhave të treguara.

Autoriteti kontraktues do t'i paguajë kontraktuesit shumën e treguar në nenin 2 të kësaj kontrate. Nuk aplikohen pagesa paraprake. Pagesa do të bëhet pas përfundimit të të gjitha detyrimeve që dalin nga kjo kontratë, shoqëruar me raporte, brenda 30 ditëve nga pranimi.

Pagesa do të bëhet në Bankën _____, ACCOUNT no. _____ IBAN no. _____ në ALL, të cilën Kontraktuesi i ka vënë në dispozicion Autoritetit Kontraktues.

Kjo kontratë i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat (15%) sipas kuadrit të legjislacionit kombëtar të Shqipërisë.

Neni 6: Kohëzgjatja e kontratës

Afati i realizimit të shërbimit, **do të jetë deri në 31 Korrik 2023 nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Neni 7: Anulimi i kontratës

Kontrata mund të pezullohet nga Kontraktuesi për një nga arsyet e mëposhtme:

- Autoriteti Kontraktues nuk përmbush pagesën dhe detyrimet e tjera.

Kontrata mund të përfundojë nga Autoriteti Kontraktues për një nga arsyet e mëposhtme:

- Kontraktuesi është në shkelje serioze të kontratës, duke mos përmbushur detyrimet kontraktuale.
- Kontraktuesi është i falimentuar ose po përfundon, po administron çështjet e tij nga gjykatat, ka hyrë në aranzhime me kreditorët, ka pezulluar aktivitetet e biznesit, është subjekt i procedimeve në lidhje me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që vjen nga një situatë e ngjashme të parashikuara në legjislacionin ose rregulloret kombëtare.

Neni 8: Gjuha e kontratës

- Gjuha e kontratës dhe e të gjitha komunikimeve me shkrim ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor dhe/ose menaxherit të projektit do të jetë shqip.

Neni 9: Kushte të tjera specifike që zbatohen për kontratën

- Nuk zbatohen kushte të tjera specifike për kontratën

Neni 10: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind ose lidhet me këtë Kontratë, e cila nuk mund të zgjidhet ndryshe, do t'i referohet juridiksionit ekskluziv të Gjykatës së Rrethit Tiranë, në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Përpiluar në gjuhën shqipe dhe angleze në 4 (katër) kopje origjinale për secilën, tre origjinale janë për autoritetin kontraktues dhe një origjinal është për kontraktorin.

Për Kontraktorin

Emri:

Titulli: Ekspert i jashtëm

Nënshkrim:

Data:

Për Autoritetin Kontraktues

Emri: Skerdi DAFA

Titulli: Administrator

Nënshkrimi:

Data:



TERMA REFERENCE

PËR VLERËSUES TË JASHTËM

Kjo është një thirrje e hapur për vlerësues kombëtar, njohës të kurrikulës të Punës Sociale, të interesuar për të ofruar një vlerësim të jashtëm të kurrikulës së Punës Sociale të ofruar nga Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, Universiteti i Tiranës.

HYRJE

Universiteti i Tiranës me mbështetjen e zyrës së UNICEF Shqipëri po zbaton programin “*Fuqizimi i kurrikulës së Punës Sociale për punonjës socialë të kualifikuar dhe të aftë për të punuar, mobilizuar dhe ndryshuar sjelljet e komunitetit*” i cili synon vendosjen e një partneritet ndërmjet UNICEF-it në Shqipëri dhe Departamentit të Punës Sociale dhe Politikave për të përmirësuar kurrikulën për punën sociale dhe politikat sociale në dy fusha kryesore: 1) Mirëqenia sociale dhe mbrojtja sociale; 2) Komunikimi për ndryshimin social dhe të sjelljes.

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të kontribuojë në forcimin e kapaciteteve para shërbimit dhe gjatë shërbimit të punonjësve socialë dhe zyrtarëve të përfshirë në adresimin/administrimin e aspekteve të mbrojtjes sociale nëpërmjet: një kurrikule të përditësuar adekuate të punës sociale të përditësuar me zhvillimet e reja në terren, duke ofruar aktivitete për ngritjen e kapaciteteve (online dhe personalisht) dhe kryerjen e vlerësimit për të ofruar një pasqyrë të situatës aktuale të komunikimit për ndryshimin e sjelljes.

Ky program është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, Ligjin për Shërbimet e Kujdesit Social në nëntor 2016, Ligjin për “Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë” në 2014, etj. Tre drejtimet kryesore të programit janë:

1. Hartëzimi, profilizimi, vlerësimi i kapaciteteve të të gjitha institucioneve dhe aktorëve kombëtarë që merren me komunikim për ndryshime sociale dhe sjellje. Vlerësimi do të shqyrtojë gjithashtu kërkesën për ndërhyrje të Komunikimit për Ndryshim Social dhe Sjelljes.
2. Të kontribuojë në fuqizimin e profesionistëve të punës sociale dhe mbrojtjes sociale përmes kurrikulave të përditësuar para shërbimit dhe gjatë shërbimit për punonjësit socialë.

3. Pasurimi i platformave dhe mekanizmave për ndarjen e rregullt dhe sistematike të praktikave të mira për zhvillimin dhe planifikimin e kapaciteteve të profesionistëve të Punës Sociale ndërmjet akademikëve, politikëbërësve dhe praktikuesve në fushën e shërbimeve të kujdesit social.

Në kuadër të këtij programi, Unversiteti i Tiranës, Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale do të vlerësojë dy programe master me qëllim rishikimin dhe përmirësimin e cilësisë së tyre në raport me tendencat e tregut të punës si edhe të politikave e praktikave aktuale në fushën e punës sociale.

Përditësimin e kurrikulave master në Punë Sociale duke i përshtatur me praktikat më të mira ndërkombëtare, si edhe në zhvillimet e reja të profesionit të Punës Sociale në Shqipëri me focus të vecantë në:

- tendencat e reja të shërbimeve të integruara sociale dhe shëndetësore,
- puna sociale në situata të emergjencave natyrore dhe
- tendencat globale të zhvillimit të qëndrueshëm,
- Urdhrin e Punës Sociale, procesin i licensimit, etj.

QËLLIMI

Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale ka ndërmarrë vlerësimin e dy programe të nivelit Master – Master i Shkencave në Punë Sociale (me tre drejtime) dhe Master Profesional Analizë e Politikës Sociale. Vlerësimi po realizohet me qëllim rishikimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve. Ai do të adresojë gjithashtu shqetësimet që lidhen me përshtatjen e programeve me nevojat e studentëve dhe integritet të tyre me sukses në tregun e punës. Aktualisht, departamenti ofron 8 programe master, 2 nga të cilët janë profesional¹ dhe 6 janë shkencor.² Ky vlerësim do të fokusohet në një Master Shkencor, i cili ka tre drejtime/specializime (politikë sociale, organizim komunitar, punë sociale klinike), dhe një Master Profesional “Analist i politikave sociale”. Vlerësimi do të nisë nga këto dy programe bazuar në diskutimet paraprake të realizuara në Departament nga stafi akademik, dhe kontaktet me alumni e studentët të këtyre programeve, duke konsideruar gjithashtu dinamikat dhe qasjet e reja të praktikave dhe shërbimeve sociale në vend, si edhe situatat emergjente me të cilat profesionistët janë përballur vitet e fundit.

INFORMACION MBI PROCESIN

Programet mësimore pritet të analizohen në bazë të standarteve dhe kompetencave të listuara më sipër. Po ashtu, do të shqyrtohet edhe praktika në institucione – nëse ka ose jo përputhje midis specializimit dhe institucionit ku studentët zhvillojnë praktikën. Analiza do të çojë në dy lloje

¹ “Analizë në Politikë Sociale” dhe “Punë Sociale e Avancuar (me dy drejtime – arsim dhe shëndetësi)”.

² “Administrim i Shërbimeve Sociale”, “Çështje të Fëmijës dhe Familjes”, “Shërbimet Sociale në Drejtësinë Penale”, “Komunikim për Ndryshimin Social dhe të Sjelljes”, “Punë Sociale (me tre drejtime)”, “Diversiteti, Shancet e Barabarta dhe Përfshirja Sociale”.

rezultatesh: (a) rezultate në nivel programi/specializimi/drejtimi dhe (b) rezultate në nivel lënde. Rezultatet mund të përdoren për të reformuar programet dhe lëndët brenda programeve.

Vlerësimi i programeve do të adresojë pyetjet e mëposhtme:

- A pajisen studentët me njohuri dhe aftësi, të cilat i bëjnë ata kompetentë në specializimin apo fushën përkatëse (dmth. politikë sociale, organizim komunitar, punë sociale klinike)?
- A sigurojnë specializimet në nivelin Master një ndarje të qartë nga niveli Bachelor? A ka koherencë, mbivendosje, apo përplasje midis dy niveleve, por edhe midis programeve të ndryshme master që Departamenti ofron?
- Çfarë mendojnë studentët dhe stafi akademik rreth potencialit të programeve në tregun e punës? Cilat janë pikat e forta dhe të dobta të programeve (analizë SËOT)? Çfarë mendojnë ata se duhet të ndryshojë?

Gjetjet paraprake të vlerësimit do të ndahen e diskutohen me stafin akademik të Departamentit dhe më pas do të paraqiten në formën e një raporti final me sugjerime konkrete për ndryshime potenciale në planin mësimor apo edhe syllabuse të vecanta. Në të ardhmen, metodologjia që do të përdoret për analizimin e këtyre dy programeve mund të përshtatet dhe përdoret për analizimin e programeve të tjera që ofrohen në departament.

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Metodologjia e parashikuara për rishikimin dhe vlerësimin e kurrikulave të propozuara përfshin:

1. Shqyrtimin e materialeve të shkruara dhe literaturën mbështetëse për analizë
2. Mbledhjen e të dhënave primare – cilësore dhe sasiore

Hapat për zbatimin e kësaj metodologjie përfshijnë:

- Shqyrtimin e programeve të lëndëve/syllabuse dhe ofrimi i komenteve; identifikimi i çështjeve që kanë nevojë të shqyrtohen më tej me mbledhjen e të dhënave primare.
- Organizimi i diskutimeve në fokus grupe dhe intervistave me profesionistë të Punës Sociale në nivel praktik të drejtpërdrejtë me individin, komunitetin dhe politikën për të marrë komente mbi kurrikulat;
- Diskutim me stafin e Departamentit të Punës dhe Politikave Sociale për të diskutuar gjetjet dhe për të gjeneruar rekomandime mbi kurrikulat ekzistuese të Punës Sociale;
- Validimi i gjetjeve nëpërmjet organizimit të një tryezë të rumbullakët me profesionistë për të finalizuar raportin përfundimtar me rekomandime;
- Finalizimi i raportit me rekomandime për përmirësimin e programeve të lëndëve dhe pasqyrimin në planin mësimor.

PRODUKTET E PRITURA

- Metodologjia
- Paketa e instrumenteve (udhëzuesi FG, lista e personave të përfshirë në FG dhe intervista)
- Shqyrtim i literaturës ekzistuese/programeve etj (analizë e krahasuese e kurrikulës dhe syllabuseve të programeve)
- Raporti paraprak
- Axhendat e tryezës për validimin e gjetjeve
- Raporti final me rekomandime

KOHËZGJATJA DHE VENDODHJA

Kjo kontratë do të zhvillohet në Tiranë dhe në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Punës dhe Politikës Sociale në UT përgjatë periudhës deri në 31 Korrik 2023.

KUALIFIKIMI I KONSULENTIT

Konsulenti duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

Kualifikime dhe eksperiencia:

- Duhet të ketë të paktën nivel master në punë sociale ose të përafërt si edhe eksperiencë në mësimdhënie në punë sociale;
- Njohje të mirë të kurrikulës së punës sociale dhe të sistemit të mbrojtjes sociale;
- Eksperiencë në studime kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Aftësi të shkëlqyera në komunikim dhe aftësi në ndërmjetësim të opinionëve dhe pozicioneve të ndryshme;
- Aftësi për të shkruar raporte vlerësimi;
- Preferohet eksperiencë mbi 10 vjet në menaxhim dhe vlerësim projektësh/programesh.
- Preferohet një nivel studimi jashtë vendit.

RAPORTIMI

Në përmbyllje të procesit, eksperti/vlerësuesi duhet të dorëzojë Universitetit të Tiranës dokumentat e mëposhtëm:

- Raportin e vlerësimit të kurrikulës me rekomandimet përkatëse
- Listën e personave të intervistuar
- Listën e personave pjesmarrës në fokus grupe

Dokumentacioni për aplikim

Aplikantët për këtë konsulencë duhet të dorëzojnë:

- Letër interesi
- CV
- Propozim të shkurtër teknik mbi metodologjinë dhe procesin